



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova -
Kosovo Agency of Statistics

HARTA RRUGORE 2019

Prishtinë, 2018



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

HARTA RRUGORE E ASK-së PËR VITIN 2019

Dhjetor, 2018
Prishtinë

PARATHËNIE

Ky dokument përmban planin e veprimit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) dhe është i bazuar në Planin Vjetor të Statistikave Zyrtare për vitin 2019 të ASK-së, si dhe në Programin e Statistikave Zyrtare 2018-2022, i cili është miratuar nga Qeveria e Kosovës.

ASK-ja gjatë vitit 2019 do të jetë e fokusuar në: zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022; zbatimin e Planit Vjetor të Statistikave Zyrtare 2019; zbatimin e Planit të Veprimit për realizimin e rekomandimeve të Raportit “Peer Review 2017”; avancimin e sistemit të planifikimit dhe të monitorimit përmes Sistemit të SIPK-ut; zbatimin e ligjeve, akteve nënligjore, të rregulloreve ekzistuese dhe ato që priten të aprovohen; ngritjen e kapaciteteve në ASK, posaçërisht në statistikat ekonomike, sociale, në TI dhe në mbledhjen e të dhënave.

Në këtë dokument janë paraqitur aktivitetet më të rëndësishme të ASK-së, që janë të bazuara në planet dhe detyrat e rregullta, të paraqitura në formë të proceseve rrugore të integruara. Përderisa, planet më të detajuara* ekzistojnë në dokumentet e brendshme të departamenteve përkatëse të ASK-së.

Në pjesën e parë të vitit 2019, sipas obligimeve nga Ligji për Statistikat Zyrtare, ASK-ja do ta përgatisë një Raport Vjetor, ku do të përfshihet performanca e departamenteve, respektivisht arritjet në ASK dhe në Sistemin Statistikor të Kosovës gjatë vitit 2018. Dallimet eventuale, ndërmjet asaj që është planifikuar dhe asaj që është realizuar, barten si pjesë e planit për vitin vijues. Sipas Ligjit të Statistikave Zyrtare të Kosovës, Raporti Vjetor dërgohet në Qeveri dhe në Kuvendin e Kosovës për miratim.

* Planet e detajuara nënkuptojnë dokumentet, që i kanë departamentet përkatëse, të cilat cilësohen si “fletë punuese”.

PËRMBAJTJE

Faqe

1. ORGANIZIMI I ASK-së.....	4
1.1 Aktivitete të rëndësishme, që priten të finalizohen në 2019	5
2. KËSHILLI STATISTIKOR	5
3. ZHVILLIMI I DEPARTAMENTEVE SIPAS PLANIT VJETOR 2019	6
3.1 Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim.....	7
3.2 Departamenti i Llogarive Kombëtare	8
3.3 Departamenti i Statistikave Ekonomike.....	9
3.4 Departamenti i Statistikave Sociale	13
3.5 Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit.....	18
3.6 Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative	21
3.7 Departamenti i Anketimeve dhe Regjistrimeve	24
3.8 Departamenti i Administratës.....	25
4. FUSHAT E MBËSHTETURA NGA DONATORËT	26
5. SFIDAT	28
6. SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE DHE QASJA.....	28
7. BUXHETI	32
Aneksi 1 - Organogrami i ASK-së.....	34

1. ORGANIZIMI I ASK-së

Me qëllim të plotësimit të nevojave të përdoruesve me të dhëna statistikore të sakta, të besueshme, në kohë dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht, ASK-ja gjatë vitit 2019 do të rrisë kapacitetet njerëzore dhe profesionale, Kjo do të ndikojë pozitivisht në rritjen e performancës dhe përmbushjes së vizionit dhe misionit të ASK-së. Përpjekjet për zbatimin e plotë të legjislacionit për prodhimin e statistikave zyrtare kanë vazhduar dhe do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2019. Ngritja e kapaciteteve njerëzore ndërlidhet edhe me obligimet e marra sipas nenit 95 të MSA-së, zbatimin e obligimeve nga ERA, si dhe zbatimin e detyrimeve nga PKZMSA-së.

Sipas Ligjit për Statistikat Zyrtare (pritet që Kuvendi i Kosovës deri në fund të vitit 2018 aprovojnë plotësim-ndryshimet e këtij Ligji), Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022, Planit të Veprimit për realizimin e rekomandimeve nga Raporti “Peer Review”, MSA-së, PKZMSA, ERA, etj, para ASK-së janë shtruar detyra dhe përgjegjësi të mëdha në ngritjen edhe zhvillimin e statistikave zyrtare në nivel vendi, në harmoni me rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare statistikore.

ASK-ja do të kryej edhe detyra për çështje të tjera, që parashihen me Ligj dhe me aktet nënligjore.

Prandaj, gjatë vitit 2019 ASK-ja planifikon:

- Përcaktimin dhe zhvillimin e metodologjisë statistikore, klasifikimin dhe përdorimin e standardeve për prodhimin e statistikave zyrtare. Për të gjitha publikimet, e dala nga ASK-ja, do të zbatohen të gjitha metodologjitë dhe standardet e statistikave evropiane;
- Ta paraqesë për miratim Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, Raportin Vjetor 2018 mbi zbatimin e planit, programit dhe shfrytëzimin e mjeteve buxhetore. Raporti vjetor i miratuar do të publikohet;
- Fuqizimin e bashkëpunimit me organizatat vendore dhe ndërkombëtare, kompetente për statistikave zyrtare, me qëllim që të mundësohet krahasimi i statistikave zyrtare të Kosovës me statistikave të prodhuara në sisteme të tjera statistikore. Do të rritet përfitimi nga bashkëpunimi statistikor me organizatat ndërkombëtare me pjesëmarrjen e stafit të ASK-së në takime, punëtori dhe seminare;
- Të rris sasinë dhe cilësinë e statistikave zyrtare
- Rritjen e koordinimit dhe komunikimit në kuadër të Sistemit Statistikor të Kosovës, sidomos tek indikatorët SDG.

1.1 Aktivitete të rëndësishme, që priten të finalizohen në 2019

- Rritja e kapaciteteve profesionale në ASK (njerëzore dhe infrastrukurore) dhe fuqizimi i statistikave sociale, ekonomike, të bujqësisë dhe sistemeve të TI.
- Mbështetje e avancuar e Teknologjisë Informative (TI) departamenteve të statistikave prodhuese në të gjitha format: planifikim, digjitalizimi i grumbullimit të të dhënave, deponimi, përpunimi, analiza dhe shpërndarja inovative e të dhënave.
- Prodhimi i statistikave sipas standardeve evropiane dhe botërore dhe zgjerimi i volumit të tyre. Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare, zbatim i metodologjisë statistikore evropiane.
- Avancimi dhe zbatimi i Kornizës së Vlerësimit të Performancës (Projekti i SIPK-ut).
- Avancimi i prodhimit të statistikave tremujore të BPV-së dhe statistikave tremujore të Tregut të Punës.
- Publikimi për herë të parë i të dhënave nga ekonomia e pavrojtuar, si dhe publikimi i statistikave mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (SILC).
- Sigurimi/rritja i/e buxhetit të nevojshëm nga buxheti i Kosovës, përmes procesit të planifikimit të buxhetit për vitin 2020.
- Zbatimin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Statistikave Zyrtare, pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe hyrjes në fuqi
- Draftimi i Projektligjit për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe banesave, 2021
- Fillimi i realizimit të Projektit katërvjeçar me KE dhe SIDA-n suedeze, MICS6 me UNICEF-in, Projektin e Regjistrimit të Popullsisë 2021, etj.

2. KËSHILLI STATISTIKOR

Pas skadimit të mandatit të Këshillit Statistikor vitin e kaluar, si dhe duke u bazuar në ndryshimet ligjore në Ligjin e Statistikave Zyrtare lidhur me përbërjen e Këshillit Statistikor e ri statistikor, ASK-ja do të zhvillojë të gjitha aktivitetet për kompletimin e këtij Këshilli. Sipas këtij ndryshimi Këshilli i ri do të përbëhet nga katërmëdhjetë (14) anëtarë dhe Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, që përfaqësojnë ministritë kyçe, Bankën Qendrore, Administratën Tatimore, universitetet, komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile, siç janë cekuar më poshtë:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale,
- Ministria e Shëndetësisë,

- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,
- Ministria e Financave,
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës,
- Universiteti i Prishtinës,
- Administrata Tatimore e Kosovës,
- Zyra e Planifikimit Strategjik pranë Zyrës së Kryeministrit,
- Dy përfaqësues nga institucione apo organizata biznesore
- Dy përfaqësues nga institucione joqeveritare apo organizata kërkimore

Këshilli i Ri Statistikor, ashtu siç ka vepruar deri më tash, do të jep rekomandime mbi përgatitjen dhe realizimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022, Planeve Vjetore, si dhe mbi zhvillimin dhe funksionimin e gjithmbarshëm të ASK-së, respektivisht Sistemit Statistikor të Kosovës.

Këshilli i ri do të themelohet me Vendim të Kryeministrit dhe do të funksionojë në mbështetje të Rregullores së ndryshuar dhe miratuar, sipas ndryshimeve të Ligjit për Statistika Zyrtare. Këshilli Statistikor do të dërgoj Raportin e vet në Qeverinë e Kosovës.

3. ZHVILLIMI I DEPARTAMENTEVE SIPAS PLANIT VJETOR 2019

Një ndër qëllimet e ASK-së është ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve profesionale sipas standardeve dhe metodologjive të kërkuara nga Eurostat. Ky zhvillim i departamenteve do të bëhet në pajtim me planin zhvillimor të ASK-së si dhe politikave të diseminimit për: rritjen numrit dhe cilësisë së statistikave zyrtare; evitimin e të gjitha gabimeve të mundshme në publikimet e ASK-së; zhvillimin e mëtejshëm të metodologjive dhe teknologjisë statistikore; zhvillimin e politikave të standardizimit dhe mbështetjen në përvojat e fituara me ekspertë ndërkombëtarë për zbatimin e këtyre standardeve.

ASK-ja, në kuadër të këtij zhvillimi, do të ofrojë ndihmë profesionale për interpretimin e saktë të të dhënave zyrtare statistikore.

ASK-ja do të ketë për bazë edhe detyrimet e cekura më lartë, në dokumentet e rëndësishme siç është, Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti "Peer Review 2017", MSA, ERA, PKZMSA, etj.

Me skemën e re organizative gjate vitit 2019, disa departamenteve në ASK do ti shtohen edhe disa pozita shtesë.

Më poshtë janë dhënë zhvillimet e parapara sipas departamenteve për vitin 2019.

3.1 Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim

Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim (DPPKK) është themeluar në bazë të Rregullores për Riorganizimin e ASK-së. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit janë të përshkruara në Rregulloren për Riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Përgjegjësitë kryesore të DPPKK, konsistojnë në procesin e planifikimit, monitorimit dhe koordinimit të aktiviteteve si brenda dhe jashtë ASK-së. Hartimi dhe zbatimin politikave në fushën e statistikave, përmirësimi dhe avancimi i bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, koordinimi (brenda ASK-së dhe Sistemit Statistikor të Kosovës), monitorimi i proceseve operative dhe strategjike si dhe komunikimi me përdoruesit e statistikave zyrtare paraqesin pikat kryesore në kuadër të përgjegjësisë të departamentit në fjalë. DPPKK, ka rol qendror në hartimin, monitorimin dhe zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022 duke përfshirë edhe planet vjetore të punës.

DPPKK-ja ofron këshilla në kuadrin e zhvillimeve vendore dhe ndërkombëtare në fushën e statistikave për ASK-në dhe Sistemin Statistikor të Kosovës, si dhe për palët e tjera të interesuara sipas nevojës. Vendimmarrja bazuar në të dhëna është një nga qëllimet e ASK-së, prandaj sigurimi i informacioneve (të dhënave analitike) të Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së lidhur me performancën e departamenteve prodhuese dhe mbështetëse në ASK është një nga detyrat parësore të këtij departamenti. Në këtë kontekst, edhe gjatë vitit 2019, do të ofrohen të dhëna analitike mbi performancën e proceseve prodhuese përmes të dhënave nga sistemi i SIPK-ut dhe burimeve të tjera mbi bazën e të cilave do të ofrohen informacione të nevojshme për top menaxhmentin e ASK-së, për vendimmarrje proaktive. Disa nga aktivitetet më të rëndësishme të cilat priten të realizohen nga DPPKK për vitin 2019 janë si në vijim: hartimi i planit vjetor të Punës Vjetor 2020, monitorimi i zbatimit të Programit të dytë i statistikave zyrtare 2018-2022, Zbatimi/monitorimi i aktiviteteve në kuadër të programit kombëtar të MSA-së, në fushën e Statistikave zyrtare (PKZMSA 2019), Zbatimi/monitorimi i aktiviteteve në kuadër të planit vjetor të punës së qeverisë (PVPQ 2019), në fushën e Statistikave zyrtare, zbatimi dhe koordinimi i strategjisë lidhur me agjendën SDGs 2030, sigurimi i përkrahjes në konferencë nga qeveria e Republikës së Kosovës, vazhdimi i monitorimit nga zbatimi i Planit të Veprimit për realizimin e rekomandimeve nga “Peer Review 2017”, hartimi dhe lëshimi i komunikatave për ngjarje operative dhe tjera me interes për shfrytëzuesit etj. Sigurimi i të dhënave qoftë në aspektin e brendshëm dhe të jashtëm si rezultat i kërkesave nga shfrytëzues të ndryshëm dhe i proceseve të integriteteve evropiane .

Ne kuadër të përgatitjeve për Regjistrimin e Popullsisë 2021 DPPKK planifikon ta hartoj strategjinë e komunikimit për këtë projekt madhor.

Avancimi i një sistemi dialogues me shfrytëzuesit e të dhënave zyrtare në mënyrë që të adresohen kërkesat e shfrytëzuesve nga pikëpamja e cilësisë dhe vëllimit të të dhënave statistikore do të jetë pjesë e planit të DPPKK-së gjatë vitit 2019 dhe në të ardhmen.

3.2 Departamenti i Llogarive Kombëtare

Sipas strukturës së re organizative të ASK-së, departamenti i Llogarive Kombëtare përbëhet nga dy divizione: Divizioni i Llogarive Kombëtare, dhe Divizioni i Ekonomisë informale dhe Llogarive qeveritare.

Në planin e vitit 2019, departamenti ka këto prioritete: shkurtimin e afatit të publikimit të të gjitha publikimeve (tremujore dhe vjetore); fillimin e publikimeve të reja, transmetimin e të dhënave në Eurostat (shtimin e numrit të tabelave) si Llogaritë Qeveritare; përmirësimin e metodologjisë së përpilimit të Llogarive Kombëtare në baza vjetore, sipas ESA 2010 dhe SNA 2008; organizimin e anketave për matjen e ekonomisë jo formale në ekonomi familjare përfundimin e detyrave të pilot-projektet e IPA 2015 (MB) me projektet e veçanta të fushave përkatëse, asistencë teknike e FMN-së për Statistikat e Financave Qeveritare, si dhe fillimi i aktiviteteve në kuadër të Asistencës teknike me Projektin Nacional IPA për Llogaritë kombëtare. Më poshtë është lista e publikimeve të pritura në Departamentin e Llogarive Kombëtare në vitin 2019.

Muaji i botimit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Llogaritë Qeveritare			TM4/2018		Vjetore 2018	TM1/2019			TM2/2019			TM3/2019
Bruto produkti vendor BVP-Qasja e Shpenzimeve & Prodhimit vjetore									2018			
BVP tremujore-Qasja e shpenz. dhe prodhimit				TM4/2018		TM1/2019			TM2/2019			TM3/2019
Rezultatet nga anketat e ekonomisë së pavrojtuar (përfshirë 4 aktivitete : hoteleri, restorante, transport dhe ndertimtari)			vjetore									

Vërejtje: Vërejtje se muaji i shkruar në kutinë e hijezuar paraqet muajin/vitin e raportuar, përderisa muaji në krye të tabelës është muaji në të cilin publikimet priten të shpërndahen.

Aktivite tjera:

Gjatë vitit 2019 planifikohen të realizohen edhe këto aktivite, sa i përket **Llogarive Kombëtare:**

Anketa mbi ekonominë e pavrojtuar e organizuar në ekonomitë familjare (financuar nga buxheti i Qeverisë së Kosovës), duke përfshirë aktivitetet e mëposhtme:

- Dizajnimi i i pyetësorit
- Mbledhja e të dhënave në terren
- Përfshirja e të dhënave dhe kontrolli logjik
- Procesimi dhe analiza e të dhënave
- Publikimi i rezultateve për ekonominë e pavrojtuar

a) Sa i përket Pilot-Projekteve të IPA 2015 (MB)* - Programi i bashkëpunimit statistikor shumë përfitues, gjatë vitit 2019 (në korrik 2019) do të përfundojnë të gjitha projektet e llogarive kombëtare:

- Statistikat e financave qeveritare GFS/EDP)
- Metodologjia e Llogarive Kombëtare (NAM);
- Programi i transmetimit në Eurostat i dhënave të Llogarive kombëtare vjetore, tremujore dhe raportimi i kualitetit
- Llogaritë sektoriale
- Identifikimi i burimit të të dhënave për kalkulimin e treguesve për sistemet e pa barazimeve makroekonomike
- Projekti SUT/IOT do të jetë pjesë e IPA Nacional: “ Forcimi i Sistemit Statistikor të Kosovës, 2018-2021”

/* Dinamika e realizimit të pilot-projekteve të IPA 2015 do të jetë sipas kontratës së nënshkruar. Të gjitha pilot projektet pritet do të përfundojnë në fillim të pjesës së dytë të vitit 2019.

3.3 Departamenti i Statistikave Ekonomike

Sipas strukturës së re organizative të ASK-së, departamenti i statistikave ekonomike përbëhet nga dy divizione: Divizioni i Statistikave të Çmimeve dhe Divizioni i Ndërmarrjeve dhe Statistikave të Tregtisë së Jashtme.

Në planin e vitit 2019, departamenti ka këto prioritete: shkurtimin e afatit të publikimit të të gjitha publikimeve (mujore, tremujore dhe vjetore); fillimin e publikimeve të reja tremujore, transmetimin e të dhënave në Eurostat (shtimin e numrit të tabelave) për statistikave të transportit, turizmit dhe energjisë; përmirësimin e cilësisë së Regjistrit të Bizneseve; përmirësimin e statistikave afatshkurtra të turizmit; përmirësimin e statistikave afatshkurtra të transportit;

përmirësimin e statistikave të çmimeve; përfundimin e detyrave të pilot-projektet e IPA 2015 (MB) me projektet e veçanta të fushave përkatëse. Fillimi i aktiviteteve në kuadër të Asistencës teknike e Projektit Nacional IPA për Statistikat ekonomike.

Më poshtë është lista e publikimeve të pritura në Departamentin e Statistikave Ekonomike në vitin 2019.

Muaji i botimit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Statistikat e tregtisë së Jashtme	Dhj 2018	Jan 2019	Shk 2019	Mar 2019	Prill 2019	Maj 2019 & 2018 vj	Qer 2019	Kor 2019	Gush 2019	Sht 2019	Tet 2019	Nën 2019
Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit	Dhj 2018	Jan 2019	Shk 2019	Mar 2019	Prill 2019	Maj 2019 & 2018 vj	Qer 2019	Kor 2019	Gush 2019	Sht 2019	Tet 2019	Nën 2019
Statistikat e Hotelisë			TM4 /2018			TM1 /2019			TM2 /2019			TM3 /2019
Indeksi i Çmimit të Importit			TM4 /2018			TM1 /2019			TM2 /2019			TM3 /2019
Bilanci i Energjisë në Kosovë		TM4 /2018			TM1 /2019	2018 vj.		TM2 /2019			TM3/ 2019	
Indeksi i Çmimeve të Prodhimit			TM4 /2018			TM1 /2019			TM2 /2019			TM3 /2019
Rep. Stat mbi Ndërmarrjet në Kosovë	TM4 /2018			TM1 /2019			TM2 /2019			TM3 /2019		
Statistikat e Transportit	TM4 /2018			TM1 /2019			TM2 /2019			TM3 /2019		
Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve												2018 vj.
Indeksi i Kostos së Ndërtimit			TM4 /2018			TM1 /2019			TM2 /2019			TM3 /2019
Statistikat tremujore për Industri			TM4 /2018			TM1 /2019			TM2 /2019			TM3 /2019
Statistikat tremujore për Tregti me Pakice			TM4 /2018			TM1 /2019			TM2 /2019			TM3 /2019
Rezultatet e Anketës së PRODCOM-it												2018 vj.

Vërejtje: Në muaji i shkruar në kutinë e hijezuar paraqet muajin/vitin e raportuar, përderisa muaji në krye të tabelës është muaji në të cilin publikimet priten të shpërndahen.

Gjatë vitit 2019 planifikohen të realizohen këto aktivitete, sa i përket statistikave ekonomike.

Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve 2018

- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill-qershor 2019;
- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, maj -shtator 2019;
- Përgatitja e të dhënave përfundimtare për BPV, shtator 2019;
- Publikimi i të dhënave, dhjetor 2019.

b) Anketa për Azhurnimin e Regjistrimit Statistikor të Bizneseve 2018:

- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), shkurt-tetor 2019;
- Kontrolli Logjik, kodimi, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, prill -dhjetor 2019.

c) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Industri, TM4 2018:

- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar -shkurt 2019;

- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, janar -mars 2019;
 - Publikimi i të dhënave, mars 2019.
- d) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Industri, TM1 2019:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill-maj 2019;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, prill-qershor 2019;
 - Publikimi i të dhënave, qershor 2019.
- e) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Industri, TM2 2019:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), korrik-gusht 2019;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, korrik -shtator 2019;
 - Publikimi i të dhënave, shtator 2018.
- f) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Industri, TM3 2019:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), tetor-nëntor 2019;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, tetor-dhjetor 2019;
 - Publikimi i të dhënave, dhjetor 2019.
- g) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Ndërtim, TM4 2018:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar - shkurt 2019;
- h) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Ndërtim, TM1 2019:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill-maj 2019;
- i) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Ndërtim, TM2 2019:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), korrik-gusht 2019;
- j) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Ndërtim, TM3 2019:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), tetor-nëntor 2019;
- k) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Tregti me Pakicë, TM4 2018:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar-mars 2019;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, shkurt-mars 2019;
 - Publikimi i të dhënave, mars 2019.
- l) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Tregti me Pakicë, TM1 2019:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill -maj 2019;

- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, maj-qershor 2019;
 - Publikimi i të dhënave, qershor 2019.
- m) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Tregti me Pakicë, TM2 2019:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), korrik-gusht 2019;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, gusht-shtator 2019;
 - Publikimi i të dhënave, shtator 2019.
- n) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Tregti me Pakicë, TM3 2019:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), tetor-nëntor 2019;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, nëntor-dhjetor 2019;
 - Publikimi i të dhënave, dhjetor 2019.
- o) Anketa për Çmimet e Kostos së Ndërtimit, TM4 2018:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar -shkurt 2019;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, janar -mars 2019;
 - Publikimi i të dhënave, mars 2019.
- p) Anketa për Çmimet e Kostos së Ndërtimit, TM1 2019:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill-maj 2019;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, prill-qershor 2019;
 - Publikimi i të dhënave, qershor 2018.
- q) Anketa për Çmimet e Kostos së Ndërtimit, TM2 2019:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), korrik-gusht 2019;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, korrik-shtator 2019;
 - Publikimi i të dhënave, shtator 2019.
- r) Anketa për Çmimet e Kostos së Ndërtimit, TM3 2019:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), tetor-nëntor 2019;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, tetor-dhjetor 2019;
 - Publikimi i të dhënave, dhjetor 2019.
- s) Anketa e PRODCOM-it 2018:
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar-mars 2019;

- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, prill-dhjetor 2019;
 - Publikimi i të dhënave, dhjetor 2019.
- t) Anketa Konsumi i Energjisë Elektrike
- Anketimi i ne teren, prill-qershor 2019;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, qershor - korrik 2019;
 - Publikimi i të dhënave, bëhet në kuadër të balancës së energjisë, shtator 2019.
- u) Pilot-Projektet e IPA 2015 (MB)¹ - Programi i bashkëpunimit statistikor me shumë përfitues IPA 2015:
- Pariteti i Fuqisë Blerëse;
 - Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit;
 - Regjistri Statistikor i Biznesit;
 - Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve; implementimi i udhëzuesve dhe standardeve të Sistemit Evropian të Statistikave (ESS);
 - Statistikat e Transportit- statistikat e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave;
 - Statistikat e Energjisë;

/* Dinamika e realizimit të pilot-projekteve të IPA 2015 do të jetë sipas kontratës së nënshkruar. Të gjitha pilot projektet pritet do të përfundojnë në fillim të pjesës së dytë të vitit 2019.

3.4 Departamenti i Statistikave Sociale

Ne kuadër të Departamentit të Statistikave Sociale (DSS) janë dy divizione: Divizioni i Statistikave Sociale dhe Divizioni i Statistikave të Popullsisë që janë përgjegjëse për prodhimin e statistikave sociale dhe statistikave të popullsisë.

Në programin e vitit 2019, DSS ka këto prioritete:

- Përgatitjet për “Regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave” projekt i cili pritet të zhvillohet në muajin Prill 2021. Bazuar në përvojën nga Regjistrimi i Popullsisë 2011 si dhe praktikën nga vendet e tjera, gjatë vitit 2019, do të fillojnë përgatitjet intensive të dokumenteve strategjike që ndërlidhen me për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2021.
- Hartimi i “**Regjistrin të popullsisë**” pritet të filloi nga mesi i vitit 2019 dhe supozohet të jete i disponueshëm në pjesën e parë të vitit 2021 (projekti do të jetë i varur nga institucionet tjera qendrore të Kosovës).

- Realizimi për herë të dytë i anketës MICS¹ në bashkëpunim me UNICEF-in.
- Përmirësimin e cilësisë së të dhënave;
- Shkurtimin e afatit të publikimeve;
- Krijimin e qasjes së ASK-së në sistemin SMIA (MASHT);
- Implementimin e ISCED 2011;
- Implementimin e Klasifikimit Ndërkombëtar të veprave penale për qëllime statistikore;
- Përfundimin e detyrave të pilot-projektet e IPA 2015 (MB) me projektet e veçanta të fushave përkatëse;
- Përfundimin e aktiviteteve në kuadër të projektit të Bankës Botërore (SDM) si dhe
- Përfundimin e aktiviteteve në kuadër të projektit me UNODC “Matja e krimit në Ballkanin Perëndimor”.

Departamenti i Statistikave Sociale do të vazhdojë me nxjerrjen e publikimeve të rregullta sipas Kalendarit të Publikimeve 2019.

Në tabelën e më poshtme kemi pasqyruar listën e publikimeve të pritura gjatë vitit 2019:

Muaji i botimit	Janar	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Rezultatet e Anketës mbi përdorimin e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit (TIK)	2018											2019
Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore			TM4 2018	2018		TM1 2019			TM2 2019			TM3 2019
Statistikat e Mirëqenies Sociale				2018	TM1 2019			TM2 2019			TM3 2019	
Statistikat e arsimit						2018/2019						
Statistikat e Lindjeve						2018						
Statistikat e Jurisprudencës për persona të mitur						2018						
Vlerësimi i popullsisë						2018						
Statistikat e Vdekjeve						2018						
Statistikat e Kurorëzimeve							2018					
Statistikat e Shkurorëzimeve							2018					
Statistikat e Jurisprudencës për personat madhor									2018			
Niveli i pagave në Kosovë									2018			
Statistikat e Kulturës										2018		
Statistikat e Shëndetësisë										2018		
Statistikat e Sportit												2018
Rezultatet e Anketës mbi të Ardhurat dhe Kushitet e Jetesës												2018

¹ Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishitë

Gjatë vitit 2019 në DSS do të realizohen aktivitetet në vijim:

1. Anketa e Fuqisë Punëtore:

- Anketimi dhe ri anketimi i ekonomive familjare të përzgjedhura në mostër janar-dhjetor 2019;
- Vlerësimi i të dhënave, përpunimi dhe analiza e të dhënave për TM4 2018;
- Përgatitja dhe publikimi i rezultateve të AFP-së për TM4 2018, mars 2019;
- Përgatitja dhe publikimi i rezultateve të AFP-së për vitin 2018 (publikimi vjetor), prill 2019;
- Vlerësimi i të dhënave, përpunimi dhe analiza e të dhënave për TM1 2019 , prill, maj, qershor 2019;
- Përgatitja dhe publikimi i rezultateve të AFP-së për TM1 2019, qershor 2019;
- Vlerësimi i të dhënave, përpunimi dhe analiza e të dhënave për TM2 2019 ,korrik, gusht, shtator 2019;
- Përgatitja dhe publikimi i rezultateve të AFP-së për TM2 2019, tetor 2019;
- Vlerësimi i të dhënave, përpunimi dhe analiza e të dhënave për TM3 2019 ,korrik, gusht, shtator 2019;
- Përgatitja dhe publikimi i rezultateve të AFP-së për TM3 2019, dhjetor 2019;

2. Niveli i pagave në Kosovë 2018

- Grumbullimi, përpunimi dhe analizimi i të dhënave, prill-gusht 2019;
- Publikimi i të dhënave, shtator 2019;

3. Anketa mbi përdorimin e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit (TIK)

- Publikimi i rezultateve të anketës TIK 2018, janar 2019;
- Grumbullimi i të dhënave të TIK 2019, prill, maj 2019;
- Vlerësimi i të dhënave, përpunimi dhe analiza e të dhënave, qershor-shtator 2019;
- Transmetimi i të dhënave të TIK në Eurostat, tetor 2019;
- Përgatitja dhe publikimi i rezultateve të TIK 2019, dhjetor 2019.

4. Anketa mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (SILC)

- Pastrimi i bazës së të dhënave të anketës SILC 2018, janar-qershor 2019;
- Grumbullimi i të dhënave në teren për anketën SILC 2019, maj-korrik 2019;
- Analizimi ,konstruktimi dhe prodhimi i indikatorëve të SILC 2018, korrik-nëntor 2019;
- Transmetimi i të dhënave (SILC 2018) në Eurostat, nëntor 2019;
- Publikimi i rezultateve të SILC 2018, dhjetor 2019;

5. Statistikat e jurisprudencës për personat e mitur

- Grumbullimi i të dhënave për TM4 2018, janar 2019;
- Grumbullimi i të dhënave për TM1, TM2 dhe TM3 2019 ,prill-dhjetor 2019;
- Kontrollimi logjik, përpunimi dhe analizimi i të dhënave për vitin 2018, janar-maj 2019;
- Publikimi i rezultateve të statistikave të jurisprudencës për personat e mitur 2018, qershor 2019.

6. Statistikat e jurisprudencës për persona madhor

- Grumbullimi i të dhënave për TM4 2018, janar 2019;
- Grumbullimi i të dhënave për TM1, TM2 dhe TM3 2019 ,prill-dhjetor 2019;
- Kontrollimi logjik, përpunimi dhe analizimi i të dhënave për vitin 2018, janar-korrik 2019;
- Publikimi i rezultateve të statistikave të jurisprudencës për personat madhor 2018, shtator 2019.

7. Statistikat e arsimit 2018/2019

- Grumbullimi i të dhënave të arsimit 2018/2019 , janar-shkurt 2019;
- Përpunimi dhe analizimi i të dhënave mars –qershor 2019;
- Publikimi i të dhënave, qershor 2019.

8. Statistikat e mirëqenies sociale

- Grumbullimi i të dhënave për TM4 2018, janar 2019;
- Përpunimi dhe analizimi i të dhënave të mirëqenies sociale 2018, shkurt, mars 2019;
- Publikimi i dhënave për vitin 2018, prill 2019;
- Grumbullimi i të dhënave për TM1 2019, prill 2019;
- Përpunimi dhe analizimi i të dhënave të mirëqenies sociale për TM1 2019, prill, maj 2019;
- Publikimi i dhënave për TM1 2019, maj 2019
- Grumbullimi i të dhënave për TM2 2019, korrik 2019;
- Përpunimi dhe analizimi i të dhënave të mirëqenies sociale për TM2 2019, korrik, gusht 2019;
- Publikimi i dhënave për TM2 2019, gusht 2019;
- Grumbullimi i të dhënave për TM3 2019, tetor 2019;
- Përpunimi dhe analizimi i të dhënave të mirëqenies sociale për TM3 2019, tetor, nëntor 2019;
- Publikimi i dhënave për TM3 2019, nëntor 2019.

9. Statistikat e Shëndetësisë

- Grumbullimi i të dhënave të shëndetësisë 2018, janar-mars 2019;
- Përpunimi dhe analizimi i të dhënave, qershor-gusht 2019;

- Publikimi i të dhënave të shëndetësisë 2018, tetor 2019.

10. Statistikat e Kulturës dhe Sportit

- Grumbullimi i të dhënave të Kulturës 2018 , prill-maj 2019;
- Kontrollimi logjik, përpunimi dhe analizimi i të dhënave, qershor-shtator 2019;
- Publikimi i të dhënave të Kulturës 2018, tetor 2019;
- Grumbullimi i të dhënave të Sportit 2018 , maj-qershor 2019;
- Kontrollimi logjik, përpunimi dhe analizimi i të dhënave, korrik-nëntor 2019;
- Publikimi i të dhënave të Sportit 2018, dhjetor 2019.

11. Statistikat Vitale (lindjet, vdekjet, kurorëzimet, shkurorëzimet)

- Grumbullimi i të dhënave për statistikat vitale (lindjet, vdekjet, kurorëzimet, shkurorëzimet) çdo muaj, janar – dhjetor 2019;
- Përfshirja në data bazë, kontrolli logjike, përpunimi, analiza e të dhënave të statistikave vitale (lindjet, vdekjet, kurorëzimet, shkurorëzimet);
- Publikim i të dhënave vjetore mbi: lindjet dhe vdekjet (qershor 2019);
- Publikim i të dhënave vjetore statistikave kurorëzimeve dhe statistikave shkurorëzimeve (korrik 2019).

ASK-ja gjate vitit 2018 ka krijuar Grupin punues ku janë të përfshira edhe institucione tjera relevante (ARC, IKSPKH, MSH, MPB, MPMS, Institucionet fetare) me qëllim që raportimi i të dhënave të statistikave vitale (*lindjeve dhe vdekjeve*) të jetë në harmoni me standardet ndërkombëtare, ku puna do të vazhdojë edhe gjate vitit 2019.

12. Vlerësimi i popullsisë 2018

- Grumbullimi i të dhënave për lindjet dhe vdekjet;
- Grumbullimi i të dhënave për imigrimet dhe emigrimet;
- Kontrolli logjik, përpunimi dhe analiza e të dhënave;
- Publikimi i të dhënave, qershor 2019.

13. Statistikat mbi shkaqet e vdekjeve në Kosovë për vitin 2016-2017

- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave mbi shkakun e vdekjes;
- Përgatitja e të dhënave përfundimtare;
- Publikimi i të dhënave, dhjetor 2019.

14. Aktivitetet tjera:

- Përgatitja e raportit final të pilot Anketës së Kostos së Punës;
- Zhvillimi i pilot Anketës për “Vendet e lira të punës”;
- Zhvillimi i pilot Anketës së Shëndetësisë.

3.5 Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

Departamenti Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit (DSBM) do të jetë përgjegjës për mbledhjen, analizimin dhe publikimin e statistikave zyrtare, të besueshme dhe me kohë për bujqësi, pylltari, statistika agro-monetare dhe të mjedisit, si dhe standardizimin e prodhimit të këtyre statistikave me BE-në.

Bazuar në strukturën e re të organizimit të ASK-së, Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit ka dy divizione në kuadër të saj: Divizioni i Statistikave të Bujqësisë dhe Divizioni i Statistikave të Mjedisit. Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit do të vazhdojë nxjerrjen e botimeve të rregullta, të parapara në Kalendarin e Publikimeve 2019. Më poshtë është lista e publikimeve të pritura në Departamentin e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit në vitin 2019.

Muaji i botimit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi (vjetor)		(2015-2018 Vjetore)										
Indeksi i Çmimeve të Inputeve dhe Çmimet në Bujqësi (Vjetor)		(2015-2018 Vjetore)										
Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi (Tremujor)		TM4/2018			TM1/2019			TM2/2019			TM3/2019	
Indeksi i Çmimeve të Inputeve dhe Çmimet në Bujqësi (Tremujor)		TM4/2018			TM1/2019			TM2/2019			TM3/2019	
Disa Fakte mbi Mjedisin 2017 - 2018			2017 - 2018, Çdo dy vite									
Gazrat Serrë (Llogaritjet e Emisioneve të Ajrit) 2017 - 2018									2017 -2018, Çdo dy vite			
Anketa e Ekonomive Bujqësore 2018 (vjetore)									2018			
Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi 2018 (Vjetore)									2018			
Anketa e Mbeturinave të Trajtuar 2018 (vjetore)										2018		
Anketa e Mbeturinave Komunale 2018 (vjetore)											2018	
Anketa e Mbeturinave Industriale 2018 (vjetore)												2018

Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e hijezuar paraqet muajin e raportuar, përderisa muaji në krye të tabelës paraqet muajin, në të cilin publikimet priten të shpërndahen.

Gjatë vitit 2019 planifikohen të realizohen këto aktivitete, sa i përket statistikave të bujqësisë dhe mjedisit.

1. Anketa e Ekonomive Bujqësore, 2018

- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave të Anketës së Ekonomive Bujqësore 2018 (AEB 2018), janar – maj 2019;
- Përgatitja e të dhënave përfundimtare për AEB 2018, maj - qershor 2019;
- Publikimi i të dhënave, qershor 2019.

2. Anketa e Ekonomive Bujqësore, 2019

- Parapërgatitja për realizimin e Anketës së Ekonomive Bujqësore 2019 (përgatitja e pyetësorit, udhëzuesit dhe e mostrës, Tetor 2019);
- Anketimi i Ekonomive Bujqësore të zgjedhura (mostra), Nëntor 2019;

3. Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2018

- Grumbullimi i të dhënave administrative për Llogaritë Ekonomike për bujqësi 2018 janar – Qershor 2019;
- Përpunimi, analiza dhe përgatitja e të dhënave përfundimtare, Korrik – Shtator 2019;
- Publikimi i të dhënave, Shtator 2019.

4. Çmimet dhe Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve në Bujqësi

- Grumbullimi i të dhënave për çmimet e prodhimeve bujqësore çdo muaj, janar – dhjetor 2019;
- Përfshirja në kompjuter, përpunimi, analiza dhe përgatitja e publikimeve tremujore dhe vjetore;
- Publikimi i të dhënave vjetore, shkurt 2019;
- Publikimi i të dhënave tremujore, shkurt, maj, gusht dhe nëntor, 2019.

5. Çmimet dhe Indeksi i Çmimeve të Inputeve në Bujqësi

- Grumbullimi i të dhënave për çmimet e inputeve bujqësore çdo muaj, janar – dhjetor 2019;
- Përfshirja në kompjuter, përpunimi, analiza dhe përgatitja e publikimeve tremujore dhe vjetore;
- Publikimi i të dhënave vjetore, shkurt 2019;
- Publikimi i të dhënave tremujore, shkurt, maj, gusht dhe nëntor, 2019.

6. Fakte mbi Mjedisin 2017/2018

- Grumbullimi i të dhënave administrative dhe të tjera për publikimin “Fakte mbi mjedisin”, janar - dhjetor 2018;
- Përpunimi, analiza dhe përgatitja e rezultateve përfundimtare, janar - shkurt 2019;
- Publikimi i të dhënave, Mars 2019 (ky është publikim periodik dhe publikohet çdo dy vite).

7. Statistikat e ajrit 2017/2018 “Emetimi i gazrave serrë” (GHGE)

- Grumbullimi i të dhënave administrative dhe të tjera për publikimin “Gazrat serrë”, janar - dhjetor 2018;
- Përpunimi dhe analiza e të dhënave janar – qershor 2019;
- Publikimi i të dhënave, Shtator 2019.

8. Anketa e Mbeturinave të Trajtuara (AMT) 2018

- Parapërgatitja për realizimin e Anketës së Mbeturinave të Trajtuara (AMT) 2018; (përgatitja e pyetësores, udhëzuesit dhe e mostrës, Janar - Maj 2019);
- Anketimi i Ndërmarrjeve Industriale të zgjedhura (mostra), Korrik – Gusht 2019;
- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, Shtator 2019;
- Përgatitja e të dhënave përfundimtare për AMT dhe publikimi i tyre, Tetor 2019.

9. Anketa e Mbeturinave Komunale 2018 (AMK)

- Parapërgatitja për realizimin e Anketës së Mbeturinave Komunale (AMK) 2018 (përgatitja e pyetësores, udhëzuesit dhe e mostrës, Janar - Qershor 2019);
- Anketimi i Ndërmarrjeve që merren me grumbullimin e mbeturinave komunale, Korrik – Gusht 2019;
- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave të AMK, Shtator 2019;
- Përgatitja e të dhënave përfundimtare për AMK dhe publikimi i tyre, Nëntor 2019.

10. Anketa e Mbeturinave Industriale 2018 (AMI)

- Parapërgatitja për realizimin e Anketës së Mbeturinave të Industriale (AMI) 2018; (përgatitja e pyetësores, udhëzuesit dhe e mostrës, Janar - Maj 2019);
- Anketimi i Ndërmarrjeve Industriale të zgjedhura (mostra), Korrik – Gusht 2019;
- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave të AMI, Tetor 2019;
- Përgatitja e të dhënave përfundimtare për AMI, Nëntor 2019;

- Publikimi i të dhënave të AMI, Dhjetor 2019.

11. Statistikat e ujit 2018/2019

- Grumbullimi i të dhënave administrative dhe të tjera për publikimin e “Statistikave të ujërave në Kosovë, janar - dhjetor 2019;
- Përpunimi, analiza dhe përgatitja e rezultateve përfundimtare, janar - shkurt 2020;
- Publikimi i të dhënave mars 2020.(ky është publikim periodik dhe publikohet çdo dy vite).

Aktivitet e tjera

1. Realizimi i pilot-projekteve në kuadër të IPA 2015:
 - a. Statistikat Vjetore të Kulturave Bujqësore dhe kulturat e përhershme bimore (Pemët dhe Vreshtat);
 - b. Statistikat e Prodhimtarisë Blegtorale (statistikat mujore dhe vjetore mbi therjet e kafshëve, statistikat mujore dhe vjetore mbi prodhimin e qumështit);
 - c. Statistikat agromonetare (llogaritjet ekonomike në bujqësi, çmimet dhe indeksi i çmimeve në bujqësi dhe pilot anketa mbi çmimet dhe qiranë e tokës bujqësore);
 - d. Anketa mbi Strukturën e Fermave (dërgimi i të dhënave të RB 2014 në Eurostat).
 - e. Statistikat e mbeturinave

3.6 Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative

Në Divizionin e Metodologjisë dhe Shpërndarjes për vitin 2018 planifikohen këto aktivitete.:

- Nxjerrjen e mostrave për të gjitha anketat e parashtruara nga statistikave prodhuese si dhe të hulumtimeve tjera në ASK,
- Nxjerrja e Mostrës për Anketën e Fuqisë Punëtore si dhe Anketën e Ekonomive familjare Bujqësore;
- Nxjerrja e Mostrës për anketën “SILC (Survey on Income and Living Conditions)”
- Nxjerrja e Mostrës për anketën “ICT (Information & Communication Technology Survey)”
- Nxjerrja e Mostrave edhe për Hulumtime tjera shitesë të cilat mundë të kërkohen nga Institucionet e ndryshme ndërkombëtare apo edhe ato vendore;
- Llogaritja e Peshave për Hulumtimet dhe Anketat e lartcekura;
- Rivlerësimi i peshave për hulumtimet e ndryshme statistikore;
- Vazhdimi i projektit për Metadata;

- Menaxhimi dhe përmirësimi i Cilësisë statistikore,
- Realizimi i Anketës së Kënaqshmërisë së Përdoruesve
- Ngritja e kapaciteteve profesionale, dokumentimi i metadatave sipas ESMS dhe ESQRS,
- Dokumentimi i të gjitha metodologjive dhe vlerësimet e tyre,
- Do të vazhdohet me përlogaritjen dhe vlerësimin e gabimeve në mostër për të gjitha anketat tjera statistikore,
- Sektori Shpërndarjes do të vazhdojnë të punojë dhe t'i mbështesë departamentet prodhuese, lidhur me kontrollimin dhe përgatitjen e të gjitha publikimeve statistikore, duke zbatuar standardet e Eurostatit, si dhe duke përfshirë këtu edhe shenjëzimin e numrit standard të ISBN-së për të gjitha publikimet vjetore të statistikave.
- Kalendarit të Publikimeve 2019 do të jetë instrument shumë i rëndësishëm, që sektori i shpërndarjes-desiminimit përgatit dhe bën kontrollimin dhe verifikimin në SIPK programin të e afateve kohore të publikimeve, në bazë të deklarimit të datave për publikimin e tyre nga përgjegjësit e departamenteve prodhuese të ASK-së.
- Informimi i shfrytëzuesve për arsyen dhe vonesën e publikimeve është një informatë shtesë ku me këtë lloj informate shfrytëzuesit e të dhënave janë të informuar me kohë lidhur me datën se kurë do të publikohen të dhënat të cilat nuk janë publikuar në afatet e caktuara kohore sipas Kalendarit të Publikimeve.
- Përkthimi i të gjitha publikimeve dhe dokumenteve zyrtare nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe angleze do të jetë punë e këtij sektori edhe gjatë vitit 2019.
- Shpërndarja e publikimeve statistikore, në mënyrë elektronike në adresat e shfrytëzuesve.
- Vazhdimi i publikimeve horizontale tremujore dhe vjetore, të cilat janë si rezultat i statistikave prodhuese do të jenë proces në vazhdimësi për prezantimin e të dhënave kyçe për shfrytëzuesit dhe përdoruesit.
- Vjetari Statistikor i ASK-së, i cili planifikohet të përgatitet gjatë muajve të parë të Vitit 2019.
- Katalogu i Publikimeve 2018,
- Kosova në Shifra 2018,
- Buletini Tremujor TM4 2018, TM1 2019, TM2 2019 dhe TM3 2019,

Ndërsa nga fusha e Shpërndarjes për vitin 2019 planifikohen të bëhen këtë publikime të ashtuquajtura horizontale:

Muaji i botimit	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
Vjetari Statistikor						2019						
Kosova në Shifra									2019			
Buletini tremujor	TM4 2018			TM1 2019			TM2 2019			TM3 2019		
Fletëpalosja e ASK-së												2019
Kalendari i publikimeve të ASK-së											2020	
Kalendari vjetor i ASK-së												2020
Katalogu i publikimeve të ASK-së			2018									

Vëreni se muaji i shkruar ne kutinë e hijezuar paraqet muajin e raportuar përderisa muaji në krye të tabelës paraqet muajin në të cilin publikimet priten të shpërndahe

Në aspektin e TI-së do të ofrohen shërbime dhe një infrastrukturë që mbështesin, përmirësojnë dhe bëjnë që proceset statistikore të prodhimit të jenë më efikase dhe efektive. Kjo i referohet përdorimit të metodave të avancuara për mbledhjen e të dhënave, dizajnimin dhe administrimin e bazës së shënimeve, analizës së të dhënave, përgatitjes së rezultateve dhe shpërndarjes moderne të të dhënave statistikore.

Viti 2019 do të jetë vazhdimësi i digjitalizimit të të dhënave në terren përmes përdorimit të sistemeve të avancuara për mbledhjen e të dhënave nga terreni, metoda CAPI (Intervistë Personale me Ndhmën e Kompjuterit) dhe CAWI ((Intervistë Personale Përmes Ueb Aplikacionit)), si dhe krijimi i sistemeve të mëtejme për shkëmbimin e të dhënave mes ASK-ës dhe institucioneve tjera qeveritare relevante.

Përdorimi i CAPI-it dhe CAWI-it është një hap i rëndësishëm për ASK-ën ngase përdorimi i këtyre metodave të mbledhjes së të dhënave do të ofrojnë cilësi më të lartë të cilësisë së të dhënave, eliminimi i pyetësorëve në letër dhe zvogëlimi i kostos së shpenzimeve të printimit. Analiza mund të fillojë më shpejt dhe rezultatet do të jenë në dispozicion më herët se metoda e gjertanishme përmes pyetësorit të shtypur.

Gjatë vitit 2019, metoda e CAPI-it do të përdoret për valën e dytë të SILC-ut, azhurnimin e qarqeve regjistruese, anketën e TIK-ut dhe AFP, si dhe disa anketa tjera nga pilot projektet e IPAs 2015, veçanërisht nga statistikat ekonomike.

Metoda CAPI do të zbatohet edhe për Anketën e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS), një anketë nga programi global i MICS-it, i krijuar nga UNICEF-i.

ASK do të investojë në TI dhe do të hartojë strategjinë për regjistrimin e popullsisë 2021. Strategjia do të analizon realizueshmërinë e regjistrimit përmes metodës CAPI si dhe përshkruan përfitimet, rreziqet dhe investimet e nevojshme.

Do të ndërmerren të gjitha hapat dhe masat e nevojshme për të siguruar konfidencialitetin e të dhënave gjatë procesit të mbledhjes, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave.

Ndërsa metoda e CAWI-it përveç përdorimit në Statistikat e Hotelerisë dhe Turizmit, do të zhvillohet edhe për Anketën e mbeturinave të trajtuara 2018-2019.

Do të ketë fuqizim të mëtejme të sistemit të GIS-it për menaxhimin e të dhënave gjeo-hapësinore si dhe përdorimi i tyre për zhvillimin e anketave të ndryshme në terren.

ASKdata tashmë është bërë mjete kryesorë i shpërndarjes së të dhënave statistikore, prandaj kjo platformë e shpërndarjes së të dhënave do të freskohet në vazhdimësi me të dhënat e fundit.

Do të shfrytëzohen potencialet e zhvillimeve të reja teknologjike, me qëllim që të përballemi me kërkesa në rritje të të dhënave dhe t'u shërbejë më mirë përdoruesve.

Do të promovohet platforma ASKdata edhe në institucione tjera qeveritare me qëllim që ky sistem të jetë si platformë unike për shpërndarjen por edhe për shkëmbimin e të dhënave.

Zhvillimi i mëtejme i ueb faqes së re në platformën ASP.NET do të vazhdojë, ku parashihet lidhja me ueb aplikacione, shpërndarja e metadatave sipas standardeve të Eurostat-it, formati ESMS si dhe zhvillimi i veglave për vizualizim dhe krijimin e Infografeve.

Do të intensifikohet bashkëpunimi me institucionet qeveritare, me qëllim të unifikimit të sistemeve dhe shkëmbimit e të dhënave administrative.

Zbatimi dhe integrimi i SharePoint në ASK, si dhe zhvillimi i mëtejme i Sistemit të Përfshirjes së Kohës (SIPK) do të vazhdojë edhe në vitin 2019.

Do vazhdohet mbështetja e departamenteve prodhuese në transmetimin e të dhënave sipas standardeve të Eurostat-it, sistemi eDAMIS.

Burimet njerëzore në fushën e TI-së do të rriten dhe do të kenë trajnime të përshtatshme në përdorimin dhe zhvillimin e aplikacioneve dhe infrastrukturave të nevojshme.

3.7 Departamenti i Anketimeve dhe Regjistrimeve

Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve (DRA) është përgjegjës në realizimin për mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave statistikore përmes raporteve dhe anketave të planifikuara nga departamentet prodhuese të ASK-ja. Ky departament sfidë në vazhdimësi do të ketë ngritjen e cilësisë sipas kriterëve dhe standardeve, shkurtimin e kohës me qëllim të rritjes së produktivitetit gjatë mbledhjes së të dhënave .

DAR ka nën menaxhimin e vet shtatë (7) Zyrrat Rajonale të ASK-së. DRA bënë menaxhimin, mbikëqyrjes dhe kontrollin e punëve dhe aktiviteteve operative të Zyrrave Rajonale të ASK-së lidhur me mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave në terren.

Ky departament në aspektin e organizimit ka pësuar disa ndryshime të vogla, ku të gjithë udhëheqësit e Zyrrave Rajonale raportojnë drejtpërdrejt te Drejtori i DRA-it mirëpo çdo punë dhe aktivitet e realizojnë në bashkëpunim të ngushtë dhe harmoni me Planin e departamenteve prodhuese të ASK-së.

DAR gjatë periudhës 2018 -2022 ka filluar me mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave me mjete dhe pajisje të TI-së, ku si mjete përdoren Tabletat dhe ku të dhënat gjatë anketimeve shkarkohen direkt në bazat e veçanta të Serverëve të ASK-së. Qëllimi kryesor është zhvillimi i praktikave dhe standardeve, ngritja e cilësisë dhe ngritjes së produktivitetit duke bërë shkurtimin e kohës së grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave për departamentet prodhuese.

Përdorimi i këtyre pajisjeve teknologjike në mbledhjen e të dhënave nga terreni ka mundësuar që grumbullimi dhe përpunimi në ASK të bëhet drejtpërdrejt dhe i shpejt nga terreni, gjë që ka ndikuar direkt në rritje në ekonomizimin dhe produktivitetin e mbledhjes së të dhënave si në sasi po ashtu edhe në cilësi, që është synim i vazhdueshëm i ASK-së që të arrihen praktikat, standardet dhe kriteret e harmonizuara me vendet e BE-së (EUROSTAT-it).

DRA në vitin 2019 në bashkëpunim me departamentet prodhues dhe tjera do të shtojë monitorimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e punëve dhe aktiviteteve gjatë realizimit të mbledhjes, grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave me qëllim të rritjes së sasisë dhe cilësisë së të dhënave të cilat ndikojnë në prodhimin e produkteve të besueshme të ASK –së për institucione vendore, ndërkombëtare dhe përdorues tjerë .

Monitorimi, kontrolli dhe mbikëqyrja do të fuqizohet edhe ndaj operatoreve ekonomik, të cilët janë kontraktues të punëve në mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave, me qëllim të ngritjes së kualitetit të të dhënave statistikore, duke ju ofruar mbështetje , trajnime dhe ndihmë profesionale para dhe gjatë kryerjes së punëve në teren.

Për realizimin e punëve dhe aktiviteteve në bazë të dinamikës së Planit dhe Programit të ASK-së për vitin 2019, DRA do t'i përgatisë raportet praktike ditore, javore, mujore dhe vjetore mbi ecurinë në realizimin detyrave dhe zhvillimin e aktiviteteve në bazë të afateve të planifikuara për vitin 2019.

3.8 Departamenti i Administratës

Departamenti i Administratës është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve administrative ditore në ASK, si: operacione financiare, kontabilitet, prokurim, rekrutime, gjegjësisht procedura, administrim i personelit (vijueshmëria në punë, largime, dosje personale, etj.), furnizime,

logjistikë, etj. Shprehur me fjalë të tjera, përgatitja e pasqyrave financiare, raporteve mujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore; shërbime të personelit, duke mbuluar mirëqenien, rekrutimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore; prokurimin dhe shërbimet për menaxhimin e kontratave (menaxhimi i aseteve, pronës dhe shërbimet e logjistikës). Në kuadër të Departamentit të Administratës janë të angazhuar një drejtor dhe 12 zyrtarë për vitin 2018.

Një prej pikave kyçe do të jetë zbatimi i Planit të Punës 2018, si dhe respektimi i të gjitha procedurave, gjegjësisht legjislacionit në fuqi, në funksion të menaxhimit të aktiviteteve të lartëcekura.

4. FUSHAT E MBËSHTETURA NGA DONATORËT

Ndihma e donatorëve ka dhënë vazhdimisht ndikim në ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe në përmirësimin e produkteve statistikore të ofruara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, për institucionet dhe përdoruesit e statistikave në tërësi.

Në kuadër të mbështetjes nga donatorët, ASK-ja ka bashkëpunim të vazhdueshëm me EU, SIDA/SCB, FMN, UNFPA, UNICEF, UNDP, etj. Prandaj fushat e bashkëpunimit do të jenë:

- Ngritja e kapaciteteve dhe ndihma në fushën e projekteve do të jetë e vazhdueshme dhe me shumë interes për ASK-në. Gjatë vitit 2018, donatorët do ta mbështesin stafin në ngritjen e kapaciteteve në shumë aktivitete të ndryshme, me numër të konsiderueshëm pjesëmarrjeje në të gjithë sektorët e statistikave. Vazhdimi i mbështetjes së stafit të ASK-së për pjesëmarrje në takime, konferenca, trajnime, takime pune, grupe të punës, që janë të planifikuara në instrumentin planifikues të aktiviteteve, MC-listë dhe nga Katalogu i takimeve “European Statistical Training Programme ESTP” mbështetur nga Eurostat-i dhe organizatat e tjera për vitin 2019.
- Koordinimi i aktiviteteve në baza mujore, për takimet e stafit të ASK-së, realizimi i takimeve, aprovimet dhe raportet e aktivitetit, etj.

Komisioni Evropian përmes Programit IPA 2015 (i planifikuar për periudhën dy vjeçare), gjatë vitit 2018-2019 ka mbështet dhe do të vazhdojë ta mbështesë ASK-në me 27 pilot-projekte, nga 21 që ishin në kuadër të programit IPA 2014

Pilot-projektet IPA 2015 periudha implementuese 2018-2019

1	Government Finance and Excessive Deficit Statistics
2	International trade in services statistics
3	National Accounts - Methodology
4	Transmission programme, annual national accounts (ANA), quarterly national accounts (QNA) and quality reporting
5	Sektor Accounts
6	Harmonised Index of Consumer Prices (HICP)
7	Price statistics - PPPs
8	Business Registers
9	Short-term business statistics: implementation of ESS guidelines and standards
10	Transport statistics – passenger and freight statistics
11	Information Society Statistics (ISS) – ICT usage data collections 2018
12	Energy Statistics
13	Labour force survey (LFS)
14	EU-SILC implementation
15	Crime and criminal justice statistics
16	Preparation of the population and housing censuses 2021
17	Crop statistics: Annual crop statistics (ACS) and Permanent crop statistics
18	Animal production statistics
29	Agri-monetary statistics
20	FSS-Farm Structure Survey
21	Waste statistics
22	Quality management
23	Implementing standards for metadata and data exchange
24	Source (basic) data required for the calculation of the MIP indicators
25	Sustainable Development Goal (SDGs) indicators
26	South East Europe 2020 (SEE2020) indicators
27	Reporting on horizontal activities

- Do të vazhdohet me aktivitetet rreth realizimit të pilote projekteve duke koordinuar aktivitetet si: ToR, kontrata, fatura, raportet dhe të të gjitha aspekteve tjera koordinuese që dalin gjatë implementimit të programit IPA në realizimin e plotë për secilin pilote projekte.
- Koordinimi i aktivitetëve me departamentet në kuadër të dërgimit të të dhënave vjetore në Eurostat për treguesit e shumtë statistikorë. Dy runde brenda vitit “Mbledhja e të dhënave”.
- Koordinimi i aktivitetëve me departamentet dhe BQK-ne në kuadër të mbledhjes dhe plotësimit të të dhënave në nivel modular për SMIS+ në baza vjetore.
- Vazhdimi bashkëpunimit me donatorët dhe koordinimi i aktivitetëve në kuadër të projekteve të mbështetura nga donatorët.
- Bashkëpunimi me departamentet dhe realizimi në kohë i proceseve statistikore.
- Koordinimi i proceseve statistikore me vendet e BE-së dhe të rajonit, harmonizimi i tyre në kuadër të Strategjisë 2014-2020.

Gjithashtu ASK-ja ka një mbështetje të lartë nga donatorë të ndryshëm në përmirësimin e proceseve të produkteve statistikore. Tabela me poshtë tregon emrin e projekteve në zbatim, si dhe emrin e mbështetjes nga donatorët:

Projektet e mbështetura nga Donatorët, që janë në proces të zhvillimit dhe ato që vazhdojnë në vitin 2018	Donatorët:
Statistikat në vendimarrje	Banka Botërore
Mbështetje e Sistemit Statistikor të Kosovës	Zyra e BE-së dhe Swedish International Development Agency (SIDA)
IPA 2015 – Programi shumëpërfitues i Bashkëpunimit Statistikor (ngritja profesionale e stafit , trajnimet afatëgjata, takime pune, vizitat studimore, kurset e trajnimit etj.	Eurostati

5. SFIDAT

Sfidat me të cilat pritet të ballafaqohet ASK-ja janë:

- zbatimi i Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022 (PSZ);
- zbatimi i Planit Kombëtar për MSA-në, në fushën e statistikave;
- sigurimi i indikatorëve, gjegjësisht monitorimi i strategjisë SEE 2020 dhe SDG;
- përmirësimi i vazhdueshëm i të dhënave statistikore;
- krijimi i një sistemi unik statistikor të TI-së;
- zbatimin e Kornizës së Vlerësimit të Performancës së PVSZ (për disa indikatorë);
- kuadri i burimit të të dhënave, ende i pamjaftueshëm
- harmonizimi i statistikave ndërmjet ASK-së dhe ministrive, që janë prodhuese të statistikave;
- Sigurimi i buxhetit të mjaftueshëm për realizimin e Projektit të Regjistrimit të Popullsisë 2021.
- implementimi i pilot-projekteve IPA 2014 dhe IPA 2015 dhe projektet me donatore tjerë.

6. SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE DHE QASJA

- Azhurnimi dhe zhvillimi i mëtejme i platformës për shpërndarjen e bazës së shënimeve ASKData do të vazhdojë, pasi objektivi i ASK-së është që edhe gjatë vitit 2018, ASKData të jetë kanali kryesor i shpërndarjes së të dhënave.
- Ofrimi i të dhënave statistikore në ueb-faqen e ASK-së në formatin PDF, Excel për të gjitha departamentet statistikore.

DATA E PUBLIKIMIT	TITULLI I PUBLIKIMIT	PERIUDHA
JANAR		
11 janar 2019	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Dhjetor 2018)
24 janar 2019	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Dhjetor 2018)
25 janar 2019	Anketës mbi Përdorimin e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit	2018
30 janar 2019	Repertori Stat. mbi Ndër. Ekon. në Kosovë	(TM4-2018)
30 janar 2019	Statistikat e Transportit	(TM4 - 2018)
31 janar 2019	Buletini Tremujor	(TM4 - 2018)
SHKURT		
08 shkurt 2019	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në Bujqësi	TM4/2018
14 shkurt 2019	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM4/2018
15 shkurt 2019	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM4/2018
15 shkurt 2019	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Janar 2019)
22 shkurt 2019	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në bujqësi	(2015-2018)
27 shkurt 2019	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(janar 2019)
28 shkurt 2019	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	(2015-2018)
MARS		
07 mars 2019	Statistikat e Hotelarisë	TM4/2018
07 mars 2019	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM4/2018
08 mars 2019	Logaritë Qeveritare	TM4/2018
8 mars 2019	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM4/2018
12 mars 2019	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Shkurt 2019)
12 mars 2019	Indeksi i Kostos së Ndërtimit	TM4/2018
19 mars 2019	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM4/2018
20 mars 2019	Statistikat Afatshkurtra të Tregëtisë me Pakicë	TM4/2018
20 mars 2019	Katalogu i Publikimeve të ASK-së	2018
20 mars 2019	Disa Fakte mbi Mjedisin	2017/2018
22 mars 2019	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Shkurt 2019)
PRILL		
02 prill 2019	Anketa së Fuqisë Punëtore	TM4/2018
03 prill 2019	Statistikat e Mirëqenies Sociale	2018
04 prill 2019	BPV me Qasjen e Shpenzimevet dhe Prodhimit	TM4/2018
11 prill 2019	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Mars 2019)

24 prill 2019	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Mars 2019)
30 prill 2019	Repertori Stat. mbi Ndër. Ekon. në Kosovë	TM1/2019
30 prill 2019	Statistikat e Transportit	TM1/2019
30 prill 2019	Buletini Tremujor	TM1/2019
MAJ		
10 maj 2019	Indeksi i Çmim. të Prodhimeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM1/2019
10 maj 2019	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Prill 2019)
15 maj 2019	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM1/2019
16 maj 2019	Indeksit Çmimeve të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM1/2019
20 maj 2019	Statistikat e Mirëqenjes Sociale	TM1/2019
24 maj 2019	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Prill 2019)
31 maj 2019	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	2018
31 maj 2019	Llogaritë Qeveritare	2018
QERSHOR		
03 qershor 2019	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	2018
05 qershor 2019	Indeksi i Çmimve të importit	TM1/2019
05 qershor 2019	Statistikat e Hotelarisë	TM1/2019
07 qershor 2019	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM1/2019
07 qershor 2019	Anketa e Ekonomive Bujqësore	2018
07 qershor 2019	Llogaritë Qeveritare	TM1/2019
11 qershor 2019	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Maj 2019)
11 qershor 2019	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM1/2019
12 qershor 2019	Indeksi i Kosotos së Ndërtimit	TM1/2019
14 qershor 2019	Statistikat e Arsimit	2018/2019
14 qershor 2019	Statistikat e Lindjeve në Kosovë	2018
18 qershor 2019	Statistikat Afatshkurtëra të Tregtisë me pakicë	TM1/2019
18 qershor 2019	Anketa e Fuqisë Punëtore	TM1/2019
18 qershor 2019	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM1/2019
15 qershor 2017	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Maj 2019)
26 qershor 2019	Statistikat e Vdekjeve	2018
27 qershor 2019	Bilanci i Energjisë në Kosovë	2018
27 qershor 2019	Statistikat e Jurisprudencës për Persona të Mitur	2018
28 qershor 2019	BPV me Qasjen e Shpenzimeve dhe Prodhimit TM1-2019	TM1/2019
28 qershor 2019	Vlerësimi i Popullsisë	2018
28 qershor 2019	Vjetari Statistikor	2019
KORRIK		
11 korrik 2019	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Qershor 2019)
17 korrik 2019	Statistikat e Kurorëzimeve në Kosovë	2018
24 korrik 2019	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Qershor 2019)
25 korrik 2019	Statistikat e Shkurorëzimeve në Kosovë	2018

11 korrik 2019	Repertori Stat. mbi Ndër. Ekon. në Kosovë	TM2/2019
14 korrik 2019	Buletini Tremujor	TM2/2019
GUSHT		
05 gusht 2019	Indeksi i Çmim. të Prodh. dhe Çmim. në Bujqësi	TM2/2019
09 gusht 2019	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi)	TM2/2019
12 gusht 2019	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK	(Korrik 2019)
15 gusht 2019	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM2/2019
20 gusht 2019	Statistikat e Mirëqenjes Sociale	TM2/2019
23 gusht 2017	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Korrik 2019)
27 gusht 2017	Kosova në Shifra	2018
SHTATOR		
03 shtator 2019	Statistikat e Jurisprudencës për Persona Madhor	2018
04 shtator 2019	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM2/2019
05 shtator 2019	Statistikat e Hotelarisë	TM2/2019
05 shtator 2019	Logaritë Qeveritare	TM2/2019
06 shtator 2019	Niveli i Pagave në Kosovë, 2018	2018
06 shtator 2017	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM2/2019
10 shtator 2019	Indeksi i Kostos së Ndërtimit	TM2/2019
11 shtator 2019	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Gusht 2019)
17 shtator 2019	Anketa e Fuqisë Punëtore	TM2/2019
17 shtator 2019	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM2/2019
18 shtator 2019	Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi	2018
18 shtator 2019	BPV me Qasjen e Shpenzimevet dhe Prodhimit	2018
18 shtator 2019	Statistikat Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë	TM2/2019
24 shtator 2019	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Gusht 2019)
24 shtator 2019	Gazrat Serrë (Llogaritjet e Emisioneve të Ajrit)	2017/2018
30 shtator 2019	BPV me Qasjen e Shpenzimevet dhe Prodhimit	TM2/2019
TETOR		
04 tetor 2019	Statistikat e Shëndetësisë	2018
11 tetor 2019	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Shtator 2019)
17 tetor 2019	Statistikat e Kulturës	2018
24 tetor 2019	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Shtator 2019)
25 tetor 2019	Anketa e Mbeturinave të Trajtuara	2018
30 tetor 2019	Repertori Stat. mbi Ndër. Ekon. në Kosovë	TM3/2019
30 tetor 2019	Statistikat e Transportit	TM3/2019
31 tetor 2019	Buletini Tremujor	TM3/2019
NËNTOR		
08 nëntor 2019	Indeksi i Çmim. të Prodhimeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM3/2019
11 nëntor 2019	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Tetor 2019)

14 nëntor 2019	Indeksi i Çmim. të Inputeve dhe Çmim. në Bujqësi	TM3/2019
15 nëntor 2019	Bilanci i Energjisë në Kosovë	TM3/2019
20 nëntor 2019	Statistikat e Mirëqenies Sociale	TM3/2019
22 nëntor 2019	Anketa e Mbeturinave Komunale	2018
22 nëntor 2019	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Tetor 2017)
29 nëntor 2019	Kalendari i Botimeve të ASK-së	2020
DHJETOR		
04 dhjetor 2019	Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve	2018
04 dhjetor 2019	Rezultatet e Anketës së PRODCOM	2018
05 dhjetor 2019	Indeksi i Çmimeve të Importit	TM3/2019
05 dhjetor 2019	Statistikat e Hotelarisë	TM3/2019
06 dhjetor 2019	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit	TM3/2019
06 dhjetor 2019	Llogaritë Qeveritare	TM3/2019
09 dhjetor 2019	Statistikat e Sportit	2018
10 dhjetor 2019	Indeksi i Kostos së Ndërtimit	TM3/2019
11 dhjetor 2019	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)	(Nëntor 2019)
16 dhjetor 2019	Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit	2019
17 dhjetor 2019	Anketa e Fuqisë Punëtore	TM3/2019
17 dhjetor 2019	Statistikat Afatshkurtra të Industrisë	TM3/2019
17 dhjetor 2019	Fletëpalosja e ASK-ës	2019
18 dhjetor 2019	Statistikat Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë	TM3/2019
23 dhjetor 2019	Rezultatet e Anketës mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës	2018
24 dhjetor 2019	Statistikat e Tregtisë së Jashtme	(Nëntor 2019)
26 dhjetor 2019	Anketa e Mbeturinave Industriale	2018
27 dhjetor 2019	BPV me Qasjen e Shpenzimeve dhe Prodhimit	TM3/2019

7. BUXHETI

Për periudhën e përmendur të Hartës Rrugore 2019, buxheti për ASK-së është si në vijim:

Buxheti për ASK 2019

Buxheti 2019	€
	MF *
Pagat & Mëditje	1,101,835.20
Mallrat dhe Shërbimet	972,960.00
Shpenzimet kapitale	150,000.00
Shpenzimet kosto	21,875.00
TOTAL:	2,246,670.20
Numri i punëtorëve	169

*Shënim:

- Buxheti ne vlere 2,096,670.20 € është nga buxheti i Kosovës i aprovuar nga MF.
- Ndërsa buxheti ne kategorinë kapitale ne vlere 150,000.00 € është i financuar nga te hyrat e AKP-së – aprovuar nga MF.
- Në kategorinë mallra dhe shërbime është i përfshirë edhe buxheti për përgatitjet e Regjistrimit të Popullsisë.

Aneksi 1 - Organogrami i ASK-së



